



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:202691

Datë: 29.07.2024

Numri i dokumentit: 05991316

P.nr.78/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Valon Hajdini dhe zyrtaren ligjore Mirlinda Gashi, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit F.F., për shkak të veprës penale-Lajmrimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.3884/2019, të datës 18.07.2024, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 29.07.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.3884/2019, të datës 17.07.2024, dhe gjykata e jepe këtë:

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

I pandehuri F.F. nga babai S., dhe nëna F. e vajzërisë Z., i lindur me datë [data e lindjes...], në..., komuna Skenderaj me vendbanim në lagjen... rruga..., me numër personal [numri i letërnjoftimit...], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.", ka kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

- Ë S H T Ë F A J T O R -

SEPSE: Më datë 26.03.2019, rreth orës 16:10 në Stacionin Policor në Skenderaj, tek personi zyrtar policor i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, i pandehuri me dashje duke e

ditur që nuk është kryerës i veprës penale ka bërë kallëzim të rremë për dhëndërrin e tij tani të dëmtuarin B.K. (B.S.), në atë mënyrë që kinëse i njëjti ia kishte vjedhur motorin e tij, të llojit YAMAHA R6, me tabela të regjistrimit [nnumri i targave...], së bashku me librezën e qarkullimit, qelësin dhe helmetën, të cilat i kishte në shtëpinë e tij në fshatin...

- Me këtë ka kryer veprën penale-Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 40, 43, 69 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 452 par.1, nenit 462 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të pandehurit i shqipton:

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej dyqind e pesëdhjetë (250) Euro të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditëve, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i pandehuri dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 € (njëzetë euro), si dhe në emër të taksës së kompensimit të viktimave të krimit shumë prej njëzetë (20.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar B.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm në këtë gjykatë me datë 18.07.2024 ka parashtruar aktakuzën PP-II.nr.3384/19, të datës 18.07.2024, kundër të pandehurit F.F. nga fshati... Komuna Skenderaj në lagjen..., rr..., për shkak të veprës penale, Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit t'i

shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale në fjalë si : Shënimi zyrtar i datës 15.07.2019, Raporti informues i datës 26.03.2019, Raporti i oficerit i datës 26.03.2019, Raporti mbi verifikimin e dokumenteve të humbura, Raporti mbi deklarimin e humbjes së taksave të automjetit, Përmbajtja e dosjes së forenzikes e datës 14.06.2019, Kontrata mbi shitblerjen e automjetit 05.07.2019, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 14.06.2019, Vërtetimi mbi kthimin e sendeve datë 14.06.2019.

Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-**Lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-së**, për çka gjykata gjeti se i pandehuri në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në përputhje me nenin 69 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoi të gjitha rrethanat në matjen e dënimit, ashtu që Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të paligjshme në të ardhmen.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për taksën në kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 36 par.3, nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 364 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.78/2024 me datë 29.07.2024.

Zyrtare Ligjore

Mirlinda Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.